



Tiranë, më 8 maj 2024

**Lënda:** Kërkesa mbi "Projektligjin për shëndetin seksual dhe riprodhues"

**Drejtuar:**

- **Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**  
**Kryetares, Znj. Lindita Nikolla**  
**Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë**
- **Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë**  
**Z. Edi Rama**
- **Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**  
**Znj. Albana Koçiu**
- **Avokatit të Popullit**  
**Znj. Erinda Ballanca**
- **Për dijeni, Presidentit të Republikës**  
**SH.T.Z. Bajram Begaj**

Shumë të nderuar,

Bazuar në të drejtat e tij statutores, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, pasi u njoh nga mediat me projektligjin "Për shëndetin seksual dhe riprodhues" ka ngritur një grup pune nga pesë komunitetet fetare, të përbërë nga specialistë: juristë, sociologë, teologë dhe mjekë dhe punoi për ta shqyrtuar atë.

Pas analizës së punës së këtij grupi, nëpërmjet kësaj letre, Këshilli Ndërfetar ngre shqetësimin, para Kuvendit dhe Qeverisë, për hedhjen për konsultim publik të këtij projektligji pa u konsultuar më herët me grupet e interesit, përfshirë Komunitetet Fetare, si dhe për mosbërjen publike të argumenteve që kanë shtyrë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale për të propozuar një projektligj me efekte negative për shëndetin e individit, fëmijës, familjes dhe shoqërisë shqiptare në tërësi.

Argumentet e shumta juridike, mjekësore, etike, sociale dhe teologjike (bashkëlidhur) përbëjnë themelet e qëndrimit tonë kundër projektligjit në formën në të cilën është paraqitur dhe nxisin rishqyrtimin e tij duke u bazuar në:

1. Moslejimin e sterilizimit si metodë kontrceptive, veç rasteve kur ka indikacion mjekësor, përcaktuar kjo nga një komision i posaçëm mjekësor dhe me kërkesë të të rriturit.
2. Stimulimin e lindshmërisë, duke shtuar kujdesin dhe mbështetjen me më shumë masa sociale, ekonomike, edukative, shëndetësore etj.



3. Rritjen e ndërgjegjësimit kundër ndërprerjes vullnetare të shtatzënisë, veç rasteve kur ka tregues mjekësor dhe është e rrezikuar jeta e nënës, përcaktuar kjo nga komisioni i posaçëm mjekësor.
4. Ndalimin plotësisht të mëmësisë zëvendësuese/surrogate në Shqipëri.
5. Mbrojtjen e konceptit të familjes me prindër nënë dhe baba.
6. Moszëvendësimin e lidhjes bashkëshortore me termin "femra pa partner".

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, si grup interesi, kërkon të ndërpritet shqyrtimi i projektligjit në fjalë pa pjesëmarrjen e tij në seancat konsultative në Ministrinë e Shëndetësisë; t'i njihet e drejta të paraqesë konstatime, propësime dhe kundërshti lidhur me projektligjin; si dhe të bëhet pjesë e dëgjësive publike të këtij projektligji. Në rast të kundërt, Këshilli Ndërfetar kërkon që projektligji "Për shëndetin seksual dhe riprodhues" të mos kalojë në Kuvendin e Shqipërisë.

Me dëshirën që kërkesat tona, të cilat përfaqësojnë vullnetin dhe qëndrimet e të gjithë besimtarëve tanë pjesë e pesë komuniteteve fetare zyrtare dhe shoqërisë shqiptare, të marrin vëmendjen e duhur nga ana juaj dhe, të gjithë së bashku, të punojmë për një të ardhme më të mirë e më të sigurt për brezat e rinj me besim te Zoti e te ligji për të mirën e përbashkët.

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe të gjithë qytetarët e saj!

Suksese dhe mbarësi në punën Tuaj!

Me respekt,

**Bordi i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë**

**Haxhi Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë**

**Fortlumenturia e Tij, Anastas Janullatos, Kryepiskop i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë**

**Imzot Gjergj Meta, Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë**

**Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjysh Botëror i Kryegjyshit të**

**Bektashianë**

**Pastor Ergest Biti, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë**

**KRYETARI**  
**Fortlumenturia e Tij, Anastas Janullatos**